



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 27704 prot.

Tiranë, më 07.11.2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE**
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTERGRIMIT EUROPIAN

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në mbështetje të ligjit nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të Kreut I të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 “Për Personelin e Administratës Doganore”, i ndryshuar, shpall konkurimin e brendshëm për pozicionet:

- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Zyra Doganore Qafë - Prushë, në Degën Doganore Morinë, Kukës, Kategoria C3 (1) një vend pune
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Zyra Doganore Tushemishtë, në Degën Doganore Qafë Thanë, Kategoria C3 (1) një vend pune
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Sektori Doganor Ballsh, në Degën Doganore Fier, Kategoria C3 (1) një vend pune
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Zyra e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Kakavijë, Gjirokaster, Kategoria C3 (3) tre vende pune
- **Doganier Peshore/Pikë Kontrolli**, Zyra e Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Sarandë, Kategoria C3 (1) një vend pune

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. të kenë shtetësi shqiptare;
2. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. të kenë arsim të mesëm.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae
3. Diplomë e shkollës së mesme e noterizuar;
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Fotokopje të letërnjoftimit;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.
12. Letër referencë dhënë nga punëdhënësi/eprori direkt i pozicionit të fundit.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

a) Pervojën

b) Kualifikimin

c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.11.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Gjon Bardhi

